

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a. me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson L. S. nga ..., kundër të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a. me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.229/2016 datë 13.06.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 01.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pathemeltë revizioni i të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi.” sh.a. me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.229/2016 datë 13.06.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.229/2016 datë 13.06.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a. me seli në Prishtinë ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.377/2015 datë 13.07.2016, është vërtetuar me të cilin nën pikën I. të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë sh.a. me seli në Prishtinë dhe detyrohet e paditura Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” me seli në Prishtinë që paditësit në emër të borxhit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1.394.449,65 €, me kamatë ligjore si për mjetet e deponuara me kursim me afat prej 1 viti pa destinim duke filluar prej datës së paraqitjes së padisë me datë 25.05.2012 deri në pagesën definitive të borxhit të gjitha këto në afatin parativ prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Në pikën II. të dispozitivit u vendos që secila palë i bartë shpenzimet e veta kontestimore.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura përmes të autorizuarit të saj ka parashtuar me kohë revizion për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale nga

ana e Gjykatës së Apelit me propozim që revizioni të aprovohet dhe të anulohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë , ndërsa lënda të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I autorizuari i paditësit ka paraqitur përgjigje në revizion duke theksuar se pretendimet nga revizioni janë të pabazuara me propozim që i njëjti të refuzohet si i pathemeltë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitave të nenit 215 lidhur me nenin 505 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Revizioni është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në mes të palëve në procedurë është krijuar raporti afarist , përmes kontratës së shërbimit të lidhur me datë 01.11.2017, me të cilën paditësi ka pasur për detyrim të pranojë dhe deponojë mbeturinat e mbledhura në deponin sanitare në ..., si dhe në deponin sanitare në Podujevë, ndërsa e paditura ka pasur për detyrim për një ton të mbeturinave të deponuara t’ia paguajë paditësit tarifën prej 5.26 €. Nga memorandumi marrëveshja e mirëkuptimit e datës 09.09.2009 është vërtetuar se palët në procedurë janë dakorduar që KRM “Pastrimi” nga muaji gusht 2009, t’ia kompensojë KMDK-së çdo muaj shumën prej 20.000.00 €, mbi bazën e borxhit aktual , ndërsa pjesën tjetër të papaguar të borxhit do t’ia llogarisë si borxh të KRM “Pastrimi” ndaj KMDK-së. Sa i përket shërbimit për të cilën do të paraqiten faturat përkatëse mujore sipas tarifave 5.26 € plus TVSH-ja për ton, pagesat duhen të bëhen në afatin kohor prej datës 15 deri më datën 20 të muajit vijues. Si dhe në këtë marrëveshje është paraparë riprogramimi i borxhit të vjetër i cili do të bëhet për afatin 5 vjeçar duke filluar nga muaji nëntor i 2009 deri në muajin nëntor të vitit 2014. Në mes palëve në procedurë po ashtu është arritur marrëveshja e inkasimit dhe riprogramimit të borxheve të ndërsjella me datë 16.03.2013 që i referohet borxheve që rrjedhin mbi bazën e deponimit të mbeturinave të KRM-së në deponin e KMDK-së për periudhën 01.02.2011 deri më 31.12.2011. Pasi që e paditura nuk i ka përmbush detyrimet e veta nga ky raport afarist paditësi ka parashtruar padinë kundër të paditurës për përmbushjen e detyrimit përkatësisht për pagesën e borxhit. Gjykata e shkallës së parë lartësinë e borxhit e ka vërtetuar me provat , faktet jo kontestuese si dhe me mendimin dhe konstatimin e ekspertit Riza Blakaj të dhënë në ekspertizën e datës 23.01.2013, me të cilën vlerësohet borxhi i

pashlyer i të paditurës ndaj paditësit për periudhën kohore 2006 deri në muajin maj të vitit 2012, e që përfshinë shumën e përgjithshme prej 1.394.449,65 €.

Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë e aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Këtë duke u bazuar në dispozitat e nenit 15,17 dhe 262 të LMD-së, dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, nga se aktgjykimi i ankimuar përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante për gjykimin e drejtë të cilat i pranon edhe ajo gjykatë. Prandaj ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, nga se duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Kjo nga se aktgjykimet e lartpërmendura përmbajnë arsyet të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje të cilat arsye i pranon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK.

Sipas dispozitës së nenit 204 të LPK, është paraparë se në arsyetimin e aktgjykimit gjegjësisht aktvendimit gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Në rastin konkret gjykata ankimore në arsyetimin e aktgjykimit të saj në tërësi ka pranuar arsyet për faktet relevante të gjykatës së shkallës së parë si të drejta dhe të ligjshme nga se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban arsyet të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë parashtruar me ankesë, prandaj pretendimet e revizionit në këtë drejtim kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara nga se arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë duhet të paraqet përgjigje në arsye të ankesës të cilat janë të mjaftueshme kur u referohet arsyeve të gjykatës së shkallës së parë të cilat i ka çmuar si të drejta, sikurse drejt ka vepruar në rastin konkret gjykata e

shkallës së dytë, përndryshe përsëritja e arsyeve nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë do të ishte i panevojshëm.

Pretendimet e parashtruara në revizion sa i përket Ligjit nr.05/L-043 për faljen e borxheve publike ku me nenin 6 par.1 shprehimisht parashihet se “personat që mund të përfitojnë nga falja e borxheve sipas dispozitave të këtij ligji duke përfshirë edhe personat që janë në procedurë gjyqësore për borxhin e papaguar dhe personat që kanë hyrë në marrëveshje për pagesën e borxheve deri me datë 31 dhjetor 2008, për të realizuar këtë të drejtë duhet të ndjekin procedurat e parapara me nenin 4 të këtij ligji”, sipas vlerësimit të kësaj gjykate të revizionit ky pretendim i revizionit është i pabazuar dhe irrelevant tani në këtë fazë të procedurës gjyqësore. Ligji mbi faljen e borxheve sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit i referohet procedurës jashtë gjyqësore e cila do të duhej të ndiqej apo të përfilllej nga personat që mund të përfitojnë nga falja e borxheve , lidhur me obligimet e pashlyera që kanë ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike për periudhën kohore deri më 31 dhjetor 2008 dhe faljes e gjobave, ndëshkimeve dhe obligimeve shtesë që rrjedh nga mos pagesa e borxhit kryesor (kryegjëz) për periudhën kohore 1 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014, e sipas kushteve të cilat janë përcaktuar shprehimisht me dispozitën e nenit 4 të Ligjit për faljen e borxheve publike, por duke përfillur dispozitat e Udhëzimit Administrativ (QRK)-nr.04/2015 për procedurat e faljes së borxheve publike. Prandaj nga këto arsye pretendimet e tilla nuk patën ndikim në marrjen e çfarëdo vendimi tjetër.

Pasi që aktgjykimi i goditur me revizion nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejt, drejt është aplikuar e drejta materiale, Gjykata Supreme në kuptim të nenit 222 të LPK, e refuzoi revizionin e të paditurës si të pabazuar duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

E.Rev.nr.30/2018 datë 01.10.2018

Kryetar i kolegjit,

Isa Kelmendi